



Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit bazik Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Ligjin Nr. 04/L-223, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr:

Qeveria e Kosovës / Vlada e Kosovës / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance	
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosovo / Tax Administration of Kosovo	
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE	
Primitje Org. Primitje Primitje	Hr. Prot. Br. Prot. Prot. No. 09-06-340
N. e Propoz. Datum	Date Date 24, 07, 19
PRISHTINE - A	

VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 01/2019

PËR TRAJTIMIN TATIMOR TË IMPORTEVE DHE FURNIZIMEVE KUR FINANCOHEN APO BASHKËFINANCOHEN DREJTPËRDREJTË NGA KOMISIONI EVROPIAN

QËLLIMI

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është që të sqaroj trajtimin tatimor për aspekte të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (tani e tutje TVSH) për importet dhe furnizimet kur financohen apo bashkë financohen drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian.

FUSHËVEPRIMI

Ky Vendim Shpjegues Publik vlen për personat që ekskluzivisht janë të përfshirë në importimin e mallrave të liruara në pajtim me nën paragrafin 2.1 të nenit 30 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH kur financohen apo bashkë financohen drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian, si dhe furnizimeve brenda vendit të liruara nga TVSH në pajtim me nën paragrafin 3.1 të nenit 33 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH kur financohen apo bashkë financohen drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian.

BAZA LIGJORE

Neni 19 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcakton:

1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetë zbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.
2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës."

Neni 28, paragrafi 1, si dhe paragrafi 2, pika a), b) dhe i) e Marrëveshjes Kornizë në mes të Kosovës dhe Komisionit Evropian mbi Marrëveshjet për Zbatimin e Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian për Kosovën në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II), datë 03.04.2015, përcakton:

1. *Përveç rasteve kur është dhënë ndryshe në një marrëveshje sektoriale apo marrëveshje financimi, tatimet, taksat dhe tarifat doganore dhe të importit dhe/ose ngarkesat me efekt të njëjtë nuk janë të kualifikueshme për IPA II. Ky rregull duhet të zbatohet në bashkë-financimin e ofruar nga përfituesi i IPA II dhe pranuesi i asistencës IPA II.*
2. *Dispozitat e mëposhtme do të zbatohen:*
 - a. *Të gjitha importet sipas kontraktorëve të Bashkimit do të lejohen të hyjnë në Kosovë pa iu nënshtruar detyrimeve doganore ose të importit, Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akcizës dhe taksave tjera të konsumit të veçantë apo të ndonjë tatimi, detyrimi ose tarife tjetër të ngjashme që kanë efekt të njëjtë. Përjashtimi i tillë do të zbatohet vetëm për importet në lidhje me mallrat e furnizuara dhe/ose shërbimeve të ofruara dhe/ose punimeve të ekzekutuara nga kontraktorët e kontraktuesit të Bashkimit sipas një kontrate të Bashkimit. Kosova do të sigurohet që importet në fjalë do të dalin nga pika e hyrjes për dorëzim tek kontraktorët e BE-së siç është kërkuar nga dispozitat e kontratës dhe për përdorim të menjëhershëm siç është kërkuar për zbatimin normal të kontratës, pa ndonjë vonesë apo mosmarrëveshje mbi zgjidhjen e detyrave, taksave apo ngarkesave të përmendura më lart;*
 - b. *Kontraktorët e Bashkimit do të përjashtohen nga TVSH-ja për çdo shërbim të ofruar dhe/ose mallrat e furnizuara dhe/ose punëve të ekzekutuara në bazë të kontratës së Bashkimit. Mallrat e furnizuara ose shërbimet e ofruara ose punët e ekzekutuara nga një kontraktues i kontraktorit të Bashkimit do të përjashtohen nga TVSH-ja deri në atë masë që ato janë të lidhura me objektivat dhe aktivitetet sipas kontratës së Bashkimit;”*
 - i. *Termi "Kontrata e Bashkimit" do të thotë çdo kontratë ose grant kontratë, duke përfshirë kontratat e nën-granteve/kredive dhe marrëveshjet e delegacionit nën menaxhim indirekt, nëpërmjet të cilit një aktivitet financohet nga IPA II, përfshirë këtu edhe bashkëfinancimin nga përfituesi i IPA II ose pranuesi i asistencës IPA II dhe i cili është nënshkruar nga Komisioni Evropian ose përfituesi i IPA II ose një përfitues i grantit. Termi "Kontrata e Bashkimit" do të mbulojë edhe dispozitat e asistencës së TAIEX-it dhe pjesëmarrjen në programet e Bashkimit, përfshirë grantet e marra në kuadër të programeve të Bashkimit dhe bashkëfinancimin e këtyre granteve;*

Neni 30, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, përcakton:

"2. Lirime të veçanta:

2.1. importet e mallrave të financuara nga të ardhurat e donacioneve të bëra për buxhetin ose nëpërmes buxhetit të Kosovës ose nën mbikëqyrjen e organeve kompetente ose të financuara direkt nga kontratat për përfitim të Ministrive, autoriteteve lokale dhe organeve tjera të rregulluara me ligj, nga organizatat ndërkombëtare ndër-qeveritare dhe agjencitë e tyre, qeveritë, agjencitë qeveritare, organizata qeveritare dhe jo-qeveritare në mbështetje të programeve humanitare dhe të rindërtimit dhe projekteve të tjera, përfshirë projektet e Integritimeve Evropiane në Kosovë; "

Neni 33, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, përcakton:

"3. Lirime të veçanta:

3.1. furnizimi i mallrave dhe shërbimeve të financuara nga të ardhurat e donacioneve të bëra për buxhetin ose nëpërmes buxhetit të Kosovës ose nën mbikëqyrjen e organeve kompetente ose të financuara direkt nga kontratat për Ministrinë, autoritetet lokale dhe organet tjera të rregulluara me ligj, nga qeveritë, agjencitë qeveritare, organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare në mbështetje të programeve dhe projekteve humanitare dhe të rindërtimit, përfshirë projektet e Integritimeve Evropiane në Kosovë;"

Neni 40 i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, gjegjësisht neni 59, paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ nr. 03/2015 për zbatim të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, përcakton kërkesat për rimbursim për kontraktorët e Komisionit Evropian, citojmë:

"3. Kërkesa për rimbursim për kontraktorët e Komisionit Evropian:

3.1. Pavarësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, personi i tatueshëm ka të drejtë të bëjë kërkesë për rimbursim të TVSH-së në baza mujore për TVSH-në e zbritshme që lidhet me furnizimet që drejtpërdrejtë financohen nga Komisioni Evropian, në pajtim me nënparagrafin 3.1 të nenit 33 të Ligjit, pa marrë parasysh shumën e kreditit të TVSH-së.

3.2. Kërkesat për rimbursim të TVSH-së sipas nënparagrafit 3.1 të këtij neni, ATK obligohet t'i shqyrtojë brenda afatit prej 30 ditësh nga data e pranimit të tyre.

3.3. Kërkesa konsiderohet valide, nëse janë përmbushur kushtet e parapara në paragrafin 2, nënparagrafët 2.2 deri 2.4 të këtij neni.

3.4. Personat e tatueshëm që nuk janë të themeluar në Kosovë, por që janë të themeluar në një Shtet Anëtar të BE-së ose në ndonjë vend që është nënshkruar i marrëveshjes IPA (duke përfshirë Kosovën), nuk kërkohet të regjistrohen për qëllime afariste në Kosovë, bazuar në nenin 26, paragrafin 2, pika c, të Marrëveshjes IPA për furnizimet që janë drejtpërdrejtë të financuara nga KE (Kontraktuesi i KE). Mirëpo, nëse këta persona sipas Legjislacionit tatimor kosovar, do të jenë obligues për të paguar tatime tjera, kërkohet që të pajisen me numër identifikues në mënyrë që të kenë mundësinë e pagesës së tatimit në Kosovë.“

LIRIMET NGA TVSH

Sipas nenit 19 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kanë epërsi ndaj ligjeve të saj. Rrjedhimisht, Marrëveshja Kornizë në mes të Kosovës dhe Komisionit Evropian mbi Marrëveshjet për Zbatimin e Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian për Kosovën në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II), që është ratifikuar nga Presidenti i Kosovës në vitin 2015, bie në kuadër të fushëveprimit të nenit 19 të Kushtetutës. Pra, kjo Marrëveshje, në përputhje me Kushtetutën është pjesë përbërëse e sistemit të brendshëm juridik të Kosovës dhe ka epërsi ndaj ligjeve të Kosovës.

Bazuar në nenin 28, paragrafin 2, pikën a) të Marrëveshjes Kornizë për IPA II, me rastin e importimit të mallrave, lirohen nga TVSH të gjitha mallrat e importuara nga kontraktorët e Bashkimit Evropian në bazë të Kontratës së Bashkimit Evropian. Gjithashtu, bazuar në nenin 28, paragrafin 2, pikën b) të Marrëveshjes Kornizë për IPA II, me rastin e furnizimit të mallrave/shërbimeve brenda vendit, lirohen nga TVSH të gjitha furnizimet (blerjet) nga kontraktorët e Bashkimit Evropian në bazë të Kontratës së Bashkimit Evropian.

Po ashtu, bazuar në nenin 28, paragrafin 2, pikën i) të Marrëveshjes Kornizë për IPA II, kontratat e Bashkimit Evropian në kuadër të Marrëveshjes Kornizë për IPA II janë të lira nga TVSH pavarësisht se a janë tërësisht të financuara apo pjesërisht të bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian, me kusht që kjo nuk është rregulluar ndryshe me ndonjë marrëveshje sektoriale apo marrëveshje financimi. Pra, lirimi vlen njësoj për të gjitha projektet që rrjedhin nga këto kontrata dhe janë të nënshkruara nga Komisioni Evropian ose përfituesi i IPA II (Kosova) ose pranuesi i asistencës së IPA II që mund të jetë: entitet publik, qeveritar, jo qeveritar ose person privat.

Importimi i mallrave, si dhe blerja e mallrave/shërbimeve brenda vendit, të bëra nga kontraktorët e Bashkimit Evropian në bazë të Kontratës së Bashkimit Evropian, janë të lira nga TVSH.

Për t'u liruar nga TVSH, importuesi/blerësi (kontraktuesi i Komisionit Evropian) duhet të dëshmoj përmes marrëveshjes së financimit / bashkëfinancimit apo ndonjë dokumenti tjetër se mallrat e importuara apo mallrat/shërbimet e blera brenda vendit, janë në harmoni me Kontratën e Bashkimit Evropian.

Në rastet kur ofrohet dëshmia nga blerësi se importimi i mallrave është duke u bërë me mjete të financuara apo bashkë financuara sipas kontratës me Bashkimin Evropian, Dogana e Kosovës do të vlerësoj dhe do të lejoj importimin pa TVSH. Po ashtu, në rastet e blerjes së mallrave/shërbimeve brenda vendit, kur ofrohet dëshmia nga blerësi se blerja e mallrave/shërbimeve është duke u bërë ashtu siç është përcaktuar me Kontratën e Bashkimit Evropian, furnizimi do të bëhet pa TVSH duke shënuar në faturë referencën e nenit 33, paragrafit 3, nën paragrafit 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH.

Në rastet kur nuk ofrohet dëshmia nga importuesi/blerësi (kontraktuesi i Komisionit Evropian), se importimi i mallrave, si dhe blerja e mallrave/shërbimeve brenda vendit është duke u bërë me mjete të financuara apo bashkë financuara nga Komisioni Evropian, atëherë importimi/furnizimi do të bëhet me TVSH.

Në rastet kur kontraktorit të Komisionit Evropian, për blerjet e parapara me Kontratën e Bashkimit Evropian i ngarkohet TVSH si në importe apo edhe në blerje brenda vendit, kontraktori i Komisionit Evropian ka të drejtë që të kërkoj Rimbursim të TVSH-së nga ATK.

RIMBURSIMI I TVSH-së

Personi, i cili është kontraktor i Komisionit Evropian dhe të cilit për blerjet e parapara me Kontratën e Bashkimit Evropian i është ngarkuar TVSH në importe nga Dogana e Kosovës apo edhe në blerje brenda vendit nga furnizuesit që janë deklarues të TVSH-së, ka të drejtë që në baza mujore të kërkoj Rimbursim të TVSH-së nga ATK.

Për të kërkuar Rimbursimin e TVSH-së të ngarkuar me rastin e importeve/blerjeve, kontraktori i Komisionit Evropian paraprakisht duhet të jetë i regjistruar për TVSH.

Kërkesa për rimbursim konsiderohet valide, nëse janë përmbushur kushtet, si në vijim:

- Të jenë përmbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme doganore dhe të TVSH-së;
- Të jenë dorëzuar të gjitha deklaratat e TVSH-së dhe deklaratat e tjera tatimore për të gjitha periudhat e kaluara;
- Të posedojë dokumentacion të mjaftueshëm për të vërtetuar kërkesën e rimbursimit të TVSH-së, si dhe
- Kërkesa për rimbursim të jetë parashtruar brenda afatit ligjor.

Kërkesat për rimbursim të TVSH-së për kontraktorët e Komisionit Evropian, ATK obligohet t'i shqyrtojë brenda afatit prej 30 ditësh nga data e pranimit të tyre.

Personi i tatueshëm në lidhje me kërkesën e rimbursimit të TVSH-së duhet t'i posedojë dëshmitë, si në vijim:

- Të gjitha faturat e blerjeve;
- Të gjitha faturat e shitjeve;
- Të gjithë dokumentacionin doganor, si dhe faturat shoqëruese të blerjeve;
- Deklaratat tatimore për të gjitha llojet e tatimeve të kërkuara;
- Çdo projekt investim;
- Çdo dokument tjetër relevant.

E DREJTA PËR TË ZBRITUR TVSH-në E ZBRITSHME

Neni 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH parasheh të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme derisa këto mallra dhe shërbime shfrytëzohen për qëllime të transaksioneve të cilat janë të liruara sipas Kapitullit XII.

PROCEDURAT E REGJISTRIMIT PËR TVSH DHE PËR TATIM NË TË ARDHURA

Personat e tatueshëm që nuk janë të themeluar në Kosovë, por që janë të themeluar në një Shtet Anëtar të BE-së ose në ndonjë vend që është nënshkruar i marrëveshjes IPA (duke përjashtuar Kosovën), nuk kërkohet të regjistrohen për qëllime afariste në Kosovë, bazuar në nenin 28, paragrafin 2, pika d), të Marrëveshjes IPA për furnizimet që janë drejtpërdrejtë të financuara nga KE (Kontraktuesi i KE). Mirëpo, nëse këta persona sipas Legjislacionit tatimor kosovar, do të jenë obligues për të paguar tatime tjera, kërkohet që të pajisen me numër identifikues tatimor në mënyrë që të kenë mundësinë e pagesës së tatimit në Kosovë. Gjithashtu ata do të pajisen me Numër Fiskal me qëllim të zbatimit të skemave speciale për rimbursim mujor pa marrë parasysh shumën e kreditit të TVSH-së.

Personat tjerë të tatueshëm do t'i nënshtrohen të gjitha procedurave të regjistrimit të biznesit, siç kërkohet me Ligjet në fuqi në Kosovë.

LËSHIMI I FATURAVE NGA PERSONI I TATUESHËM QË KRYEN FURNIZIME TË LIRUARA

Një person i tatueshëm që kryen furnizime të liruara në pajtim me nenin 33, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, duhet të lëshojë faturë në pajtim me rregullat normale për lëshimin e faturave.

Personi i tatueshëm, që nuk ngarkon TVSH në këto fatura, është i obliguar të paraqes arsyen për lirim. Prandaj furnizuesi me rastin e lëshimit të faturës, në faturë duhet të shënoj tekstin si në vijim: "Furnizimi është i liruuar, sipas (përmendni dispozitat përkatëse të ligjit)". Një referencë duhet t'i bëhet kontratës apo ndonjë dokumentit të ngjashëm për të cilën është bërë furnizimi.

KONTRAKTUESIT DHE NËNKONTRAKTUESIT

Kontraktuesit:

Kontraktues i Komisionit Evropian është një person fizik jo-afarist, person fizik afarist, person juridik apo organizatë tjetër që ka të lidhur një kontratë financimi apo bashkëfinancimi të drejtpërdrejtë me Komisionin Evropian.

Kontraktuesi i Komisionit Evropian, për t'u liruuar nga TVSH, duhet të dëshmoj përmes marrëveshjes së financimit apo ndonjë dokumenti tjetër se mallrat e importuara apo mallrat/shërbimet e blera brenda vendit, janë në harmoni me Kontratën e Bashkimit Evropian.

Nënkontraktuesit:

Për qëllime të këtij Vendimi Shpjegues Publik, "Nënkontraktues" apo furnizues i kontraktuesit do të konsiderohet secili person i cili nuk është nënshkruar i Kontratës në mes të Komisionit Evropian dhe kontraktuesit të tij.

Nën-kontraktues i Komisionit Evropian është një person fizik jo-afarist, person fizik afarist, person juridik apo organizatë tjetër që ofron furnizim të mallrave/shërbimeve për kontraktuesin e Komisionit Evropian.

Furnizuesit apo nën-kontraktuesit e kontraktuesit (deklarues për TVSH) që kryejnë furnizime të liruara për kontraktuesin e Komisionit Evropian nuk i nënshtrohen lirimeve speciale, por zbatojnë skemën e rregullt të TVSH-së. Blerjet të cilat ata i kryejnë duhet të ngarkohen me TVSH, nëse blerjet i bëjnë nga Personi i tatueshëm – deklarues për TVSH, si dhe nëse malli/shërbimi është furnizim i tatueshëm.

Furnizimet (shitjet nga nënkontraktuesit) që do t'i bëjnë për kontraktorin e Komisionit Evropian, aty ku ju ofrohet dëshmia nga blerësi se blerja e mallrave/shërbimeve është duke u bërë ashtu siç është përcaktuar me Kontratën e Bashkimit Evropian, furnizimi do të bëhet pa TVSH duke shënuar në faturë referencën e nenit 33, paragrafit 3, nën paragrafit 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH.

Në pajtim me rregullat e përgjithshme, nënkontraktorët e Komisionit Evropian, bëjnë zbritjen e TVSH-së së zbritshme dhe për shumën e kreditimit të mbetur të TVSH-së kanë të drejtë të kërkojnë Rimbursim nëse plotësojnë kriteret e përcaktuara me nenin 40 të Ligjit për TVSH, si dhe kriteret e përcaktuara me nenin 59, paragrafin 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015 për zbatim të Ligjit të TVSH-së.

HYRJA NË FUQI

Ky Vendim Shpjegues Publik, hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së dhe si i tillë shfuqizon Vendimin Shpjegues Publik nr. 03/2013 të datës 04.11.2013.

Data: 24/01 / 2019
Prishtinë,

Bashkim Shala

Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së
